



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2024:227630

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06095129

PPP.nr.68/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike të përmbarimit, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve: B.M dhe Xh.M, që të dy nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati A.M nga Rahoveci, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar V.G, lidhur me përmbarimin e dokumentit përmbarues aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec C.nr.430/2022, të datës 13.05.2024, i plotfuqishëm nga data 19.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024, i lejuar me urdhrin për përmbarim P.nr.1314/24, i datës 22.07.2024, të përmbaruesit privat R.H nga Prizreni, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 28.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.1314/24, i datës 22.07.2024 të përmbaruesit privat, R.H nga Prizreni, ndërsa MBETET në fuqi i njëjti urdher për përmbarim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

**A r s y e t i m**

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat R.H nga Prizreni, ka caktuar përmbarimin sipas urdhrin për përmbarim P.nr.1314/24, të datës 22.07.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec me numër C.nr.430/2022, të datës 13.05.2024, i plotfuqishëm nga data 19.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 176.00 euro.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përbarimi, debitori, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhrin për lejimin e përbarimit, me pretendimin se me aktgjykimin C.nr.430/2022 të datës 13.05.2023 kreditorit i është aprovuar kërkesëpapia për kompensim, në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, si dhe debitori Komuna e Rahovecit nuk është e detyruar që ta kryej këtë detyrim, por për këtë detyrim obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 02.08.2024, duke cekur se gjykata në procedurën përbarimore nuk mundet që dokumentin përbarues (titulus executionis) ta ndryshoj, apo ta shfuqizojë urdhrin përbarimor në kuptim të nenit 71 par.1 pika 1.8 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhrin për caktimin e përbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Gjykata me analizimin e propozimit për përbarim P.nr.1314/24, të datës 22.07.2024, aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, C.nr.430/2022, të datës 13.05.2024, i plotfuqishëm nga data 19.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024, ka ardhur në përfundim se sipas këtij aktgjykimi, debitori është i detyruar që kreditorëve në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale t'iu paguajë shumën prej 176.00 euro. Gjykata vlerëson se dokumenti përbarues, aktgjykimi C.nr.430/2022, i përmbush të gjitha kushtet ligjore konform LPP-së nenit 22 par.1 nënpar.1.1, nenit 23 par.1 dhe nenit 24 par.1 në të cilët përcaktohet se (neni 22 par.1 nënpar.1.2) "*Dokumente përbaruese janë: 1.2. vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbarues*", neni 23 par.1 "*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore.....*", neni 24 par.1 "*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare*. Ndërsa në nenin 27 par.1 përcaktohet se "*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*". Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përbarimor sepse i njëjti ka marrë formën e prerë, ka të përcaktuar kreditorët dhe debitorët, kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe shumën e përmbushjes. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket pretendimit të palës debitore se me aktgjykimin C.nr.430/2022 të datës 13.05.2023 kreditorëve i është aprovuar kërkesëpapia për kompensimin, në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, si dhe debitori Komuna e Rahovecit nuk është e detyruar që ta kryej këtë detyrim, por për këtë detyrim obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për gjykatën ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se në procedurën përbarimore gjykata është e lidhur me dokumentin përbarimor dhe vlen parimi rigoroz formal, ndërsa çështjet e ngritura nga pala debitore, si të drejta subjektive mund të realizohen në procedurën kontestimore.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 23 par.1, 24 par.1, neni 27 par.1, neni 71,73 neni 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbare, si dhe nenit 382 par.1 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.68/2024, me datë 28.08.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.